

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRËN

Nr. / Br. 27150/25  
Nr. i fq. / Br. st. - 8 -  
Data: / Datum: 18.06.25

VUSHTPRL - VUÇITRËN



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB 105/25, 16/06/2025**

**PROCESVERBAL**

**nga mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 19 maj 2025  
në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:10.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Adnan Lahu, Agron Perçuku, Fakte Dushi, Sylejman Mehollli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Hava Mlinaku (Nënkryetare e komunës), drejtorët e drejtorive.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Lidhur me Qarkoren Buxhetore do të na njoftojë drejtori i financave.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – i njoftoi të pranishmit se Qarkorja Buxhetore 2026/01 ka ardhur të premtën dhe për seancë të kuvendit do t'ua përcjellim.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se këto ditë ka qenë fundi i sezonit të kategoritë e sporteve. Klubi i hendbollit “Samadrexha F” U-18 janë shpallur kampion në nivel të Kosovës. Duke u bazuar në Rregulloren për dhënien e dekoratave, neni 9, paragrafi 3 thotë që për arritje, klubit kolektiv i ndahet shpërblimi në shumë 5,000€. Andaj, propozoj që të futet pikë e rendit të ditës që t'i ndahet këtij klubi çmimi “Krenaria e Sportit të Vushtrrisë” që parasheh edhe shumën prej 5,000€ dhe kërkoj që ta përkrahni këtë propozim. Në këtë rast, e falënderoj edhe Komunën e Vushtrrisë që është munduar herë pas here ta mbështesin këtë klub dhe kjo arritje e klubit është edhe falë mbështetjes së kryetarit të komunës.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – pa u llogarit subjektive, meqenëse bëhet fjalë për klubin e Samadrexhës, por me të vërtetë na kanë bërë krenar. Prandaj, e mbështes propozimin e Agronit që çmimi “Krenaria e Sportit të Vushtrrisë” në bazë të rregullores t'i ndahet këtij klubi.

**Sylejman Mehollli, anëtar i KPF-së** – diskutimi im ka të bëjë me mungesën e propozim-vendimit për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave, ashtu siç ka qenë e rregulluar me rregullore, ku kemi vepruar vazhdimisht. Nuk e di pse nuk ka ardhur ky propozim-vendim, apo po tentohet të sillet direkt në kuvend. Pastaj, në kuvend po dalin shumë propozime dhe po krijohet një tolloni.

**Izet Miftari, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport** – deklaroi se si komision i kemi bërë tri propozime për ndarjen e çmimeve: “Emblema e Vushtrrisë”, “Hasan Prishtina” dhe “Pena e Artë”. Kurse, është çështje e komitetit dhe kuvendit nëse ka propozime tjera.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri vendosi që të shtohen në rend të ditës:**

- **Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore për vitin 2026/01;**
- **Çmimi “Krenaria e Sportit të Vushtrrisë”, të jetë pjesë e pikës 2.**

**Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për” aprovoi këtë:**

## **R E N D D I T E**

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 11.04.2025;
2. Propozim- vendim për ndarjen e dekoratave për Ditën e Çlirimit;
3. Draft-Rregullore për dhënien e dekoratave;
4. Propozim- vendim për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në Komunën e Vushtrrisë;
5. Kërkesë për mbështetje financiare për znj. Ajmane Ferati;
6. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore për vitin 2026/01;
7. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 11.04.2025.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 11.04.2025.**

2. Propozim- vendim për ndarjen e dekoratave për Ditën e Çlirimit.

**Mentor Hasani, anëtar i KPF-së** – fillimisht klubit hendbollistik “Samadrexha” ja urojë marrjen e kupës së Kosovës. Por, edhe klubi i basketbollit i vajzave “Vushtrria Basket” U16 janë shpallur kampion të Kosovës. Prandaj, propozoj që edhe ky klub të jetë pjesë e propozimit.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se Mentori e ka të drejtën, sepse këto janë kategori të klubeve. Klubi i Samadrexhës U14 në hendboll është në garë për të fituar trofeun e Kosovës. Po ashtu, klubi i futbollit U15 edhe ata e kanë fituar kupën, ku trajner është Ilir Izmaqi. Prandaj, mos t’i barazojmë si klube. Por, sportistët e Vushtrrisë meritojnë të gjithë përkrahje.

**Izet Miftari, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport** – rregullorja nuk e saktëson se a ndalohet që çmimi “Krenaria e Sportit të Vushtrrisë” t’i jepet një individ apo një kategori kolektive. Pra, nuk e ndalon që t’u jepen edhe dy klubeve. Por, i kemi edhe OJQ-të tjera që duhet t’i subvencionojmë. Andaj, duhet ta shikojmë se sa ka buxhet drejtoria në kategorinë e subvencioneve.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – sportistët e kanë fituar çmimin dhe duhet të gjenden mjete financiare për t’ua dhënë, sepse u takon me rregullore. Unë personalisht më shumë e vlerësoj titullin e çmimit që i ndahet një klubi, sesa mjetet

financiare. Jam e bindur që klubi "Samadrexha" e ka fituar këtë çmim. Kështu që, ne jemi para aktit të kryer.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – ideatorja dhe hartuesja e këtij çmimi ("Krenaria e Sportit të Vushtrisë") në rregullore kam qenë unë, gjatë mandatit si drejtoreshë. Dua ta lexoj nenin 9 të rregullores për dekorata, sepse që 4 vjet ende nuk e kemi kuptuar. Por, mirë që kish ardhë propozimi për ta ndryshuar rregulloren dhe ndoshta atë që e bëni vet e kuptoni. Neni 9: Çmimi "Krenaria e Sportit të Vushtrisë" iu ndahet sportistëve individual (një sportisti) dhe sportit kolektiv (një klubi sportiv) për arritje kulminante në sport në gara me karakter nacional apo ndërkombëtar". Këtu shumë qartë shkruan se ideja është që klubet kur luajnë me dikë jashtë vendit me karakter nacional dhe ndërkombëtar dhe jo për klubet që brenda Kosovës fitojnë kupa me njëra tjetrën. Atëherë, klubi i hendbollit "Vushtrria" ka qenë në superligë dhe ideja pse e kemi bërë këtë rregullore ka qenë, sepse ky klub ka luajtur me një klub në Austri. Kjo ka qenë hera e parë që një klub i Vushtrisë ka dal jashtë vendit për të luajtur. Kjo ka qenë arsyeja që kur të kthehen me ua jep këtë çmim, sepse kanë qenë në krizë financiare.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – ideja e financimit të klubit, OJQ-ve, personave juridikë dhe individual është e rregulluar me Rregulloren e Ministrisë së Financave nr. 04/2017 që parasheh mënyrën e ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike. Krejt çka kemi ndarë subvencione në kuvend kanë qenë të kundërligjshme dhe disa herë e kanë kaluar filtrin në ministri dhe janë kthyer pozitive e disa herë janë kthyer të kundërligjshme. Përtej këtyre situatave, mendoj që ka filluar të keqpërdoret kuvendi në mënyrë abuzive dhe kemi filluar të bëhemi tepër jokorrekt e joparimor. Të gjitha subvencionet e kategorive të ndryshme që po vijnë në kuvend po vijnë me të njohshëm. Edhe te klubet, dikush është i afërt me klubin dhe me kryesinë e klubit i ka raportet e mira dhe në këtë mënyrë vijnë propozimet për subvencionim. I gëzohemi suksesit të secilit klub, por duhet të tregohemi në nivel të detyrës dhe duke mos anuar dhe t'i trajtojmë të gjitha klubet në mënyrë të barabartë. Për këtë arsye është thirrja publike, ku formohet komisioni, i cili ka përfaqësues edhe nga shoqëria civile dhe ndarja të bëhet në mënyrë meritore. E jo në këtë formë kështu, klubi e fitoi një turne e tash t'ja ndajmë disa mjete financiare. Mos ta harrojmë klubin e futbollit "Vushtrria", i cili është në prag të superligës dhe është në krizë financiare, ku futbollistët që disa muaj nuk kanë marrë paga.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – ato që po i thotë kolegu se vendimet për subvencionim në kuvend janë joligjore, i kemi bërë bashkë Sylejman edhe në mandatet tjera, jo vetëm në këtë mandat. Asnjëherë nuk janë bërë me qëllim të keq. Shumë herë kemi thënë edhe në mandatet tjera se po e aprovojmë këtë kërkesë edhe pse 90% kemi qenë të sigurt se do të kthehet e kundërligjshme. MAPL-ja nuk e dimë a po punon me disponim a me anime, sepse një vendim të njëjtë një komune ja kthen ndryshe komunës tjetër ndryshe. Mos të merret që po e përkrahu Samadrexhën, vetëm pse jam prej atij vendi. Por, po u them që në klubin e vajzave të Vushtrisë e kam numrin më të madh të nxënësve të mia, edhe në basketboll po ashtu. Prandaj, jam përkrahëse e sportistëve femra. Klubi i Samadrexhës është me traditë të begatshme, sepse në një kohë vajzat e këtij klubi kanë luajtur hendboll, kurse disa vajza të vendeve tjera nuk kanë guxuar me dal as deri te dera e shtëpisë. Prandaj, po e them që ky klub e meriton këtë çmim. Nëse mendoni që mund të ketë ndonjë konflikt të interesit, unë mund të largohem edhe nga diskutimi, por edhe nga votimi. Por, fatkeqësisht këtij klubi ju kanë bërë padrejtësi vazhdimisht dhe nuk është përkrahur sa duhet as në këtë mandat e as në mandatet e kaluara.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – basketboli e disa tjera janë shkolla të futbollit dhe nuk janë klube. Prandaj, duhet të bëhen këto dallime. Nuk jam kundër tyre, por ato fitojnë me thirrje publike. Ato shkolla të futbollit marrin para nga lojtarët, kurse klubet kanë shpenzime të mëdha.

**Izet Miftari, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport** – tha se nuk mund të bëhet thirrje publike për çmim, sepse këtë po e përcakton rregullorja.

*Lidhur me çmimin “Krenaria e Sportit të Vushtrrisë”, KPF-ja me tetë (8) vota “për” rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

*Agron Perçuku nuk merr pjesë në votim për shkak të shmangies të konfliktit të interesit, pasi që është pjesë e kryesisë së klubit.*

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – lidhur me çmimin “Emblema e Vushtrrisë”, kryetari i komunës i ka sjell dy propozime. Forma se si kryetari po silltet karshi çmimeve, ndarjes së mirënjohjeve edhe nderimeve të personaliteteve, realisht e ka degraduar këtë proces. Është dashur që të ruhet një lloj kredibiliteti lidhur me ndarjen e çmimeve kryesore sipas rregullores, që jo çdokush të arrijë të marrë çmime të tilla. Pararojë e kësaj është dashur të jetë qeveria komunale dhe komisioni, por edhe kuvendi. Ky çmim ndahet për kontributin e dhënë për çështje kombëtare. Deri tani këtë çmim e kemi ndarë për figura të luftës çlirimtare. E mbështes propozimin për Dibran Perçukun për kontributin e tij në luftë dhe arsim. Kurse, jam kundër propozimit për Arsim Gërxhaliun. Mjafton të kujtohet rasti i Dino Asanajt dhe Astrit Deharit. Kjo është e njëjtë sikur të nderohen vrasësit e Havzi Nelës në Kukës. Prandaj, i kam rezervat e mia dhe nuk e votoj Arsim Gërxhaliun. Propozimi im është që të hiqet nga propozimi Arsim Gërxhaliu dhe të mbetet vetëm Dibran Perçuku.

**Izet Miftari, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport** – ne si komision kemi vlerësuar që z. Arsim Gërxhaliu ka dhënë kontributin e tij për të pagjeturit dhe kjo është arsyeja që e kemi propozuar.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – cili është kontributi i Arsim Gërxhaliu për Vushtrrinë? Po ashtu, edhe nuk është banor i Vushtrrisë. Për çështjen e të pagjeturve, ai paguhet për atë punë, sepse e ka profesion. Edhe unë jam kundër dhe nuk e votoj Arsim Gërxhaliun.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – e përkrahu propozimin e Sylës që propozimet “Emblema e Vushtrrisë” të votohen ndaras.

*Lidhur me çmimin “Emblema e Vushtrrisë”, KPF-ja me pesë (5) vota “për” rekomandoi që çmimi t’i ndahet z. Dibran Perçuku dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim. Kurse, katër (4) vota ishin që ky çmim t’i ndahet z. Dibran Perçuku dhe z. Arsim Gërxhaliu.*

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – lidhur me çmimin “Hasan Prishtina”, fatkeqësisht e kemi situatën e njëjtë ndoshta edhe më keq, sepse këtu nuk jemi për asnjërin. Vëllezërit Novosella mund të nderohen nga komuna e Prishtinës, sepse edhe atje banojnë dhe punojnë, ku me veprimtarinë e tyre në ndërtimin e banesave edhe i lidh me komunën. Unë i kam lexuar disa libra të tyre edhe disa shkrime, ku janë të mbushura me mllef, urrejtje,

shpërlye dhe ngjyrimet politike. Vushtrria ka shumë personalitete që janë më meritore sesa t'u ipen disa banorëve të Prishtinës. Është dashur familjes "Novosella" t'ia ndani një çmim, e jo tre vëllezërve nga një çmim. Andaj, unë nuk do t'i votojë.

**Adnan Lahu, anëtar i KPF-së** – duhet të jemi shumë të kujdesshëm ne si anëtarë të kuvendit, e sidomos në propozime të tilla. Unë personalisht s'po i njoh vëllezërit Novosella. Por, nuk mund t'i hedhim poshtë të gjitha propozimet, sepse po dalim joscrioz.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – sa e di unë Selatin Novosella ka marrë një çmim. Prandaj, sigurohuni se çfarë çmimi ka marrë.

**Izet Miftari, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport** – deklaroi se Selatini ka qenë i burgosur politik. Arsyeja ka qenë që mos t'i ndajmë në këtë propozim. Vëllezërit Novosella janë me prejardhje nga fshati Maxhunaj. Andaj, është mirë të kalojë si propozim.

*Lidhur me çmimin "Hasan Prishtina" për vëllezërit Sabri, Selatin dhe Bedri Novosella, KPF-ja me shtatë (7) vota "për", dy (2) "kundër", asnjë "abstenim" rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – shumë më erdhni çudi që e pashë emrin e Mentor Hasanit prapë të propozuar për ndarjen e çmimit "Pena e artë". Mentori është subvencionuar për botimin e një libri, por edhe në aktivitete dhe komisione tjera, si dhe jeton në Prishtinë. Çka i keni borxh këtij personi që po i ndani tash edhe çmim? Ka personalitete mjaft në Vushtri. Nuk jam kundër Mentorit, sepse e njoh edhe personalisht. Por, ideja ime është se pse njerëzit e njëjtë po subvencionohen.

**Izet Miftari, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport** – dua të jem i sinqertë dhe korrekt me juve. E kemi vlerësuar se e meriton këtë çmim Mentori dhe nuk ka qenë qëllimi të mjetet financiare prej 300 euro që e parasheh rregullorja. Ky personalitet edhe pse nuk jeton në Vushtri është shumë i lidhur dhe kontribuon për Vushtrrinë.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – prapë po them që ka shumë personalitete. Po më vjen keq me përmend një dajë timin (vëlla i nënës), Jusuf Vatovci, i cili ka kontribuar shumë dhe është njeri modest. Është doktoranti i parë nga lëmi i fizikës në Vushtri. Kurse, unë nga modestia nuk e kam propozuar. Por, ka edhe shumë personalitete tjera që kanë dhënë kontribut.

**Adnan Lahu, anëtar i KPF-së** – pajtohem me Fatmiren për mënyrën e përzgjedhjes. Pavarësisht a ka ndonjë preferencë politike Mentori, mendoj se e meriton këtë çmim. Ne duhet të jemi krenar me vushtrriasit tanë që japin kontribut në komunat tjera e në universitet. Si propozim e përkrahim, por kur të bëhen propozimet duhet të analizohen.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – diskutimi ynë duhet të bëhet se a e meriton Mentori këtë çmim apo jo. Duke qenë të vetëdijshëm secili prej nesh se ka edhe personalitete tjera që kanë dhënë kontribut. Është e natyrshme që në këso raste të ketë mendime të ndryshme.

**Sylejman Mehollë, anëtar i KPF-së** – Mentori është një profesionist i ri dhe personalisht e kam shok. Nuk jemi kundër Mentorit, por jemi kundër vizionit tuaj të përzgjedhjes që ju e

keni si qeverisje. Jeni të verbër për t'i parë ata që nuk mendojnë si ju. Mjafton të kthehemi 3-4 vite prapa dhe e gjen që dy vushtrias i ke shkencëtarë të vitit në Republikën e Kosovës. Mentori është larg prej tyre, pavarësisht që e kam shok. Është shkencëtar i vitit, Valdet Uka, doktor i shkencave farmaceutike me notë mesatare 10.0, me dhjetëra punime dhe citime ndërkombëtare, njohës i 3-4 gjuhëve të huaja. Valbona Mehmeti, doktorë e shkencave të kimisë, me dhjetëra punime dhe citime shkencore ndërkombëtare.

*Lidhur me çmimin “Pena e artë” për Mentor Hasanin, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim. Obligohet komisioni ose drejtorja që ta përgatis propozim-vendimin për çmimin “Krenaria e Sportit të Vushtrisë”.*

**Izet Miftari, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport** – lidhur me propozim-vendimin për çmimin “Krenaria e Sportit të Vushtrisë”, pasi që është propozim i KPF-së, le ta përgatit sekretaria e kuvendit.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se komisioni ose drejtorja në bashkëpunim me sekretarinë e kuvendit le ta përgatisin propozim-vendimin.

### 3. Draft-Rregullore për dhënien e dekoratave.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se sipas meje kjo duhet të jetë plotësim-ndryshim i rregullores, e jo draft-rregullore e re, sepse ka pak ndryshime. Këtë dokument e kam analizuar dhe do t'i paraqes propozimet e mia: Te neni 13 – çmimi “Poeteshat shqiptare”, është normale që të rriten çmimet, por janë pak të larta. Çmimi i debutueses të mos mbetet 100€, por të bëhet 300€. Te neni 14 - çmimi “Pena e artë” iu ndahet personaliteteve të shquara nga fusha e shkencës dhe arsimit.....”, duhet t'i shtohet edhe e kulturës. Te neni 15 është një gabim teknik, në shenjë mirënjohjeje duhet të jetë, jo mirënjohje. Te neni 17 “Sportisti i vitit”, paragrafi 4 ka mbetur në gjysmë, të përmirësohet. Është shtuar edhe çmimi “SHKA Hasan Prishtina 1996-1998, Vushtri”.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – sa e pashë në këtë draft janë bërë ndryshime të vogla. Te neni 4 – llojet e dekoratave është shtuar çmimi “SHKA Hasan Prishtina 1996-1998, Vushtri”. A mund ta dimë se pse është specifikuar ky çmim për këtë periudhë? A është përgatitur që ky çmim t'i ipet ndonjë personi? Nuk besoj që ansambli është kaq i ngushtë me dy vite kontribut. Mendoj që ka njerëz që kanë dhënë kontribut në ansambël, duke filluar prej themeluesve e deri më tani, ku na bëjnë krenar me performancën e tyre si në Vushtri, si jashtë Vushtrisë e Kosovës. Unë jam kundër që ky çmim të jetë pjesë e rregullores.

Te neni 13 – çmimi “Poeteshat shqiptare”, çmimet janë të larta: vendi i parë (1500€), i dytë (1000€) dhe i tretë (500€). Ajo propozoi që këto çmime të jenë kështu: vendi i parë (1000€), i dytë (750€) dhe i tretë (500€). Çmimi i debutueses të jetë 300€, kurse pjesëmarrësve tjera po më duket e panevojshme t'ju ipen 100€, mund t'u ipet ndonjë lule në shenjë mirënjohjeje për pjesëmarrje.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – lidhur me çmimin “SHKA Hasan Prishtina 1996-1998, Vushtri”, është e vërtetë që Gani Hyseni ka diskutuar edhe me të tjerët, kërkesën e ka pasur edhe te ne, ku e kam proceduar në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport. Kjo shoqëri kulturore artistike në atë kohë ka qenë shumë aktive dhe nuk bëhet fjalë për një person, por i njoh disa prej tyre. Profesor Shaban Krasniqi, Ferat Muli ka qenë

në atë kohë. Është e vërtetë që nuk ka pasur koncerte apo shfaqje në shtëpinë e kulturës, por zakonisht janë bërë nëpër shkolla, bodrume të shkollave. Isha edhe unë e pranishme kur kemi qenë të përndjekur, e po ashtu shumë nxënës, studentë, mësime dhe njerëz të kulturës që edhe sot janë pjesë e kulturës që kanë marrë pjesë në organizime të ndryshme dhe e kanë mbajtur gjallë shpirtin kulturor në atë kohë. Kjo nuk ka të bëjë me ansamblin e sotëm. E kam përjetuar në lëkurën time se sa e vështirë ka qenë atëherë me u dëgju telat e qiftelisë, sepse sot flasim lirshëm. E kam përjetuar vet në një aktivitet në shkollën “Ali Kelmendi”, ku jemi përndjekur nga policia dhe shumica prej tyre janë marrë. Nuk mendoj që Gani Hyseni është ai që na nxiti ta mohojmë atë periudhë. Prandaj, ky propozim është i arsyeshëm.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – nuk ka arsye të figurojë ky çmim në rregullore. Këtyre njerëzve mund t’u ipet mirënjohje për veprimtarinë e tyre në atë kohë. Nuk kemi çmim për liri e as për rezistencë, ku pikërisht ajo kohë ka qenë për rezistencë, ku njerëzit e kanë dhënë edhe jetën e tyre. Kurse, po tentohet të ipen çmime për çifteli e këndim. Ky propozim është i pakuptimtë. Propozoj që neni të emërtohet çmimi “Gani Hyseni 1996-1998”, sepse është iniciator i saj dhe na ka kontaktuar edhe përmes telefoni.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – në vitet e vështira 1996-1998, shpirtin gjallë e ka mbajtur kultura. Çiftelia është ajo që i ka nxitur shumë djem e vajza – ushtarë të UÇK-së. Në kërkesën e tyre, janë të nënshkruar anëtarët e kësaj shoqërie kulturor-artistike. Nuk është e rëndësishme për mua që ky çmim të mbetet apo jo, e rëndësishme është që ne të gjallët ta respektojmë dhe ta vlerësojmë secilën periudhë dhe kontribut.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se çka do të ndodhë kur t’u ipen çmimet të gjithë atyre njerëzve që kanë qenë të angazhuar në këtë ansambël? Pse në prag të zgjedhjeve po ndodhin këto propozime?

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – ky çmim i ndahet dikujt nga fusha e artit dhe kulturës, jo vetëm këtyre.

**Fatmirë Cecelia, anëtare e KPF-së** – nuk po e kontestojmë kontributin e askujt në këtë periudhë. Por, emërtimi nuk është në rregull. Ky Gani Hyseni i ka thirr njerëzit në telefon (mua jo) dhe u ka thënë që kalone këtë rregullore, sepse mua kanë me ma jep çmimin. Unë jam kundër që paragrafi 1.5, i nenit 4 të shtohet në rregullore.

**Izet Miftari, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport** – nuk do doja ta personalizoj këtë me emrin e Gani Hysenit. Ai i ka përfaqësuar një grup të madh të njerëzve dhe në emrin e tyre e ka bërë kërkesën. Edhe unë kam bërë pyetje se pse nuk po bëhet plotësim-ndryshim i rregullores, por rregullore e re. Kryesuesi i komisionit Fatmir Feka ka pasur që të vij në mbledhje, por ka pasur një seancë gjyqësore. Ai më ka thënë që ka disa ndryshime dhe duhet të jetë rregullore e re. Në kuvend do të merr pjesë, kryesuesi i komisionit. Lidhur me takimet e poeteshave, ndoshta çmimet janë pak të larta, por komisioni ashtu i ka propozuar. Kemi dashur që mos ta lëmë nën hije, sepse është një festival, i vetmi i këtij lloji në trojet shqiptare.

**Lidhur me paragrafin 1.5 të nenit 4 “SHKA Hasan Prishtina 1996-1998, Vushtrri”, KPF-ja me pesë (5) vota “për”, katër (4) “kundër” rekomandoi që mos të jetë pjesë e rregullores dhe mos të procedohet për kuvend në mbledhjen e radhës për shqyrtim.**

*Lidhur me nenin 13 – Çmimi “Poeteshat shqiptare”, vendi i parë – 1000€, vendi i dytë – 750€, vendi i tretë – 500€. Çmimi “debutuesja” - 300€, pjesëmarrësit që nuk fitojnë çmim – 100€, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

*KPF-ja njëzëri rekomandoi që me këto ndryshime të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

4. Propozim- vendim për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në Komunën e Vushtrrisë.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – lidhur me këtë, kërkoj që sa herë të na vjen ky komision për t’u zgjedhur, të na sillt edhe një biografi e anëtarëve të këtij komisioni që ta dimë se kush janë dhe cila është përgatitja e tyre profesionale.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

5. Kërkesë për mbështetje financiare për znj. Ajmane Ferati.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore për vitin 2026/01.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

7. Pyetje dhe përgjigje.

Mbledhja përfundoi në orën **12:00**.

**Bujar Klinaku**



**Procesmbajtës**

**Melihate Basholli - Latifi**

**Kryesuese e KK-së dhe KPF- së**

